



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 02.03.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Arkesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.02.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Malesia&Alb-Tief Bau SHPK", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve"**, me Nr. të Prok: **616 -17-2458-521** nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Malesia&Alb-Tief Bau SHPK" e datës 27.02.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve"**, me Nr. të Prok: **616 -17-2458-521**, Nr. Brendshëm _616 17 063 521 kundër *[Njoftimit për Refuzim të tenderit, të datës 26.02.2018]*;
2. Vërtetohet Njoftimi i AK për *refuzim të tenderit të dërguar me datë 26.02.2018*;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Malesia&Alb-Tief Bau SHPK" me datë 27.02.2018 ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve"**, me Nr. të Prok: **616 -17-2458-521**; me Nr. të brendshëm të prokurimit: 616 17 063 521. Autoriteti Kontraktues, me datë 27.02.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:
1) Pretendimi i parashtruesit të kërkesës lidhur me faktin se nuk është marrë për bazë dergesa elektronike lidhur me kërkesat e pikave 9.1&9.2 nuk është i bazuar, pasi që në dergesën e cekur

jane derguar te njejtat materiale qe kane qene pjese e tenderit dhe per kete ne Njoftimin per refuzimin e tenderit i eshte sqaruar ne menyre decisive se nuk ka dorezuar katalogun sipas kerkeses ne dosje te tenderit edhe pas kerkeses per sqarim dhe plotesim. Nga kjo rrjedh se komisioni me te drejt materailin e derguar nuk e ka pranuar si katalog pasi qe aty ka vetem fotografi te shenjave dhe nuk ka asnej specifikim dhe pershkrim qe do ta kategorizonte ate material si katalog.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e dhëna më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit